

# ANALIZA E PUNËS

## DHE

## VEPRIMTARISË SË GJYKATËS

# 2021

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**

# ANALIZA E PUNËS DHE VEPRIMTARISË SË GJYKATËS PËR VITIN 2021

## HYRJE

Në këtë analizë të veprimtarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, përshkruhet veprimtaria e plotë dhe organizimi i brendshëm i saj gjatë vitit 2021. Analiza ka në përmbajtje të saj një përshkrim të përgjithshëm të gjykatës, procesin e punës, menaxhimin e seancave gjyqësore, aktorët e sistemit të drejtësisë, të dhëna për çështjet gjyqësore të mbartura nga viti 2020 dhe ato të reja, çështjet për të cilat është disponuar nga ana e gjykatës me vendim pranimi dhe rrëzimi, pushimi etj, administrimin e gjykatës, veprimtarine e saj, afatet kohore proceduriale dhe vlerësimi. Gjithashtu në brendësi të analizës gjenden tabela dhe grafikë përsa i përket çështjeve të paraqitura për gjykim, kohëzgjatjes, statistikave mbi ankimet, cilësia në gjykim, statistikat për çështjet civile, familjare, statistikat për çështje penale, seanca paraprake, masa sigurimi, paraqitje dhe analizë e treguesve statistikorë në vite, si dhe krahasimi me vitet e tjera. Gjykata e Kurbinit funksionon e pa ndarë në dhoma penale dhe civile për shkak të numrit të vogël të trupës gjyqësore. Vlen të përmendet se gjatë vitit 2021 është përballuar një volum shumë i madh çështjesh me nje numër prej 4 gjyqtarësh , ku gjyqtare Alda Sadiku ka filluar punën në muajin prill 2021. Përvec ngarkesës së çështjeve të Gjykatës, nga ana e trupës gjyqësore janë përballuar edhe komandimet e gjyqtareve ne gjykatat e tjera, si në Lezhë, Krujë, Mat, Dibër, Tiranë etj, me një volum të madh çështjesh. Gjykata i është përgjigjur Këshillit të Lartë Gjyqesor dhe Ministrisë së Drejtësisë me informacion dhe të dhëna statistikore të kërkuara në periudha kohore 3 mujore dhe jo vetëm, të dhëna këto voluminoze dhe që në të shumtën e rasteve kanë kërkuar punë manuale dhe e gjithë kjo punë është përballuar nga punonjësit e administratës së gjykatës. Gjykata i është përgjigjur gjithashtu me informacion medias dhe çdo subjekti të së drejtës që ka kërkuar informacion konform dispozitave ligjore për të drejtën e informimit. Komunikimi është interaktiv, i përditshëm dhe kryhet në kohë reale. Megjithë volumin e madh të punës është bërë e mundur të përmbushen me korrektësi detyrimet ligjore përsa i përket transparencës në mardhënie me të tretët.

## PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin e ushtron veprimtarinë e vet në një godinë 3-katëshe, ku vetëm dy kate të saj shfrytëzohen nga ana e gjjykatës pasi kati i III shfrytëzohet nga ana e Prokurorisë Kurbin. Po ashtu në katin e parë një pjesë e ambienteve të godinës shfrytëzohen nga ana e Zyrës së Përmbarimit Kurbin dhe Zyra e Shërbimit të Provës Kurbin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për shkak të trupës gjyqësore dhe konkretisht e përbërë nga katër gjyqtar, veprimtaria e vet e kryen pa u ndarë në dhoma. Gjyqtarët kanë shpërndarje normale, penale dhe civile në një dhomë.

## STAFI I GJYKATËS

1. Gjyqtarë : 4
2. Kancelar : 1
3. Kryesekretar : 1
4. Sekretare Gjyqësorë: 5
5. K/Deges Buxhetit: 1
6. Specialist IT/ Marredhënien me Publikun : 1
7. Arkiviste: 1
8. Nëpunës gjyqësor : 1
9. Ftues : 1
10. Punonjës sigurie: 1
11. Sanitare: 1
12. Shofer:1

***Gjithsejt 19 punonjës.***

Një tregues mjaft i rëndësishëm i punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është numri i çështjeve gjyqësore që janë gjykuar nga kjo gjykatë për vitin 2021. Krahasuar me vitin 2020 shihet qartë se është rritur numri i çështjeve të gjykuara dhe numri i çështjeve të përfunduara, fakt që tregojnë rritje në efiçencën e punës së gjykatës në dhënien e drejtësisë në kohë.

Numri i çështjeve të gjykuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

## TABELA 1. NUMRI I ÇËSHTJEVE TË ARDHURA DHE GJYKUARA PËR VITIN 2021

| LLOJI ÇËSHTJEVE | PENALE THEMELI | KËRKESA PENALE | MASA SIGURIMI | CIVILE THEMELI | KERKESA CIVILE | SHUMA |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ÇËSHTJE NË PRITJE NË 1 JANAR 2021 | 39 | 51 | 0 | 182 | 40 | 312 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ÇËSHTJE NË PRITJE NË 31 DHJETOR 2021 | 36 | 54 | 0 | 179 | 57 | 326 |
| ÇËSHTJE TË ARDHURA | 233 | 445 | 162 | 530 | 383 | 1753 |
| ÇËSHTJE TË PËRFUNDUARA | 236 | 442 | 162 | 533 | 366 | 1739 |
| TOTALI PËR GJYKIM | 272 | 496 | 162 | 712 | 423 | 2065 |




**TABELA 2**. ÇËSHTJE TË GJYKUARA SIPAS GJYQTARËVE NË GJYKATË PËR VITIN 2021

| **Emër, Mbiemër** | **Çështje të gjykuara** | **Penale** | | **Civile** | | **Kërkesa Penale** | | **Kërkesa Civile** | **Shuma si kryesues** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **I vetëm dhe kryesues** | **Trup Gjykues** | **I vetëm dhe kryesues** | **Trup Gjykues** | **Masa Sigurimi** | **Kerkesa Penale** | | |
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | *6* | | *9* | *10* | *11* |
| DED MIRI *(50 %)* | 402 | 54 | 3 | 127 | 0 | 52 | 96 | 70 | 399 |
| AUREL ARAPI | 557 | 70 | 1 | 178 | 0 | 40 | 148 | 120 | 556 |
| OLTI SKRAME | 548 | 61 | 3 | 172 | 0 | 49 | 137 | 126 | 545 |
| ALDA SADIKU | 235 | 45 | 4 | 55 | 0 | 21 | 60 | 50 | 231 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| GJYQTARET E RRETHEVE | 19 | 6 | 11 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 8 |
| **TOTAL** | **1761** | **236** | **22** | **533** | **0** | **162** | **442** | **366** | **1739** |

Në këtë tabelë pasqyrohet në tërësi çështjet e gjykuara nga ana e trupës gjyqësore të gjykatës për vitin 2021 e ndarë për secilin gjyqtar më vete sipas treguesve, në çështje të natyrës penale, natyrës civile dhe si kryesues apo anëtar trupi gjykues




Nga të dhenat e paraqitura ne tabelat e mësiperme del që të gjithë gjyqtarët kanë patur ngarkesë shumë voluminoze të gjykimit në total të çështjeve konkretisht: ***Ded Miri*** me **399** çështje (*me ngarkesë pune në masë të reduktuar - 50%, me cilësine e zv.kryetarit të gjykatës*), ***Aurel Arapi*** me **556** çështje, ***Olti Skrame*** me **545** çështje, ***Alda Sadiku*** (*ardhur ne muajin prill 2021* ) me **231** çështje, dhe gjyqtarë të rretheve me 24 çështje. Nga të dhënat qe kancelaret e rretheve Kruje, Lezhe , Mat na kane vene ne dispozicion , rezulton se gjyqtaret e gjykates sone kane patur delegime ne total si më poshtë:

Ded Miri, 2 çështje civile në proces. Aurel Arapi, ka përfunduar 2 çështje penale dhe dy çështje në process. Olti Skrame, ka 2 çështje të përfunduara dhe 3 në process.

Alda Sadiku, ka përfunduar 1 dhe ka në proces 1 çështje.

Ngarkesa e punës si numër çështjesh relativisht është e konsiderueshme, por duhet sqaruar se edhe natyra e disa çështjeve penale e civile që gjykohen nga kjo gjykatë kërkojnë me shumë kohë e më shumë ndjenjë

përgjegjesie për t'u gjykuar, duke parë edhe rrezikshmërinë e madhe shoqërore të disa veprave penale të kryera, si dhe konfliktet e shumta civile që ekzistojnë në këtë rreth.
Përsa i përket shpërndarjes së çështjeve për gjyqtar realizohet nëpërmjet shortit të organizuar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ai është kryer nëpërmjet sistemit informatik-kompjuterik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore **ICMIS dhe AUDIO,** ku të gjitha çështjet e ardhura për gjykim, si civile ashtu edhe penale i janë nënshtruar tërësisht këtij sistemi. Sipas detyrimeve të përcaktuara në vendimet dhe ligjin përkatës, janë zbatuar periodikat e hedhjes së tij si përsa i përket ditës dhe orës së hedhjes, ashtu edhe transparences së tij duke e hedhur në prani të të gjithë palëve të interesuara, si regull një herë në javë ditën e hënë ora 13.00.

**Aktorët e sistemit të drejtësisë**

Gjykata ka një komunikim të mirë dhe frytëdhënës me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, që ndihmon në mbarëvajtjen e punës për të dy institucionet dhe është përmirësuar ndjeshëm bashkëpunimi dhe koordinimi nëpërmjet takimeve të rregullta për çështje dhe problematika të përbashkëta që shqetësojnë të dy institucionet në shërbim të mbarëvajtjes së punës.
Mbetet për të punuar akoma mbi bashkëpunimin me Dhomën e Avokatisë për shkak të problematikave që janë hasur me caktimin e avokatëve kryesisht, procedure që duhet ndjekur dhe përzgjedhjen e tyre sipas specializimit. Kjo pasi avokatët e përcaktuar në listën e gadishmërisë së sjellë nga Dhoma e Avokatisë nuk gjenden në afërsi të ambienteve të gjykatës në ditët e caktuara dhe në mjaft raste ka lindur nevoja që të vijohet me avokatët që vijnë më pas në rradhë, duke u bërë shkak për vonesa në zhvillimin e seancave gjyqësore dhe shtyrje të seancave gjyqësore. Sa i përket njoftimeve elektronike për avokatët dhe institucionet shtetërore dhe jo vetëm, vlen të përmendet se është bërë një punë e kënaqshme e koordinuar por që lidhur me këtë mënyrë komunikimi nevojitet bashkëpunim më i kënaqshëm me subjektet e interesuara.

**PROCEDURAT NË GJYKATË**

Personat e interesuar i drejtohen gjykatës me anë të mjeteve procedural të parashikuara nga ligji procedural si me anë të kërkesave, kërkesëpadive, ankesave të cilat depozitohen dhe trajtohen nga zyra përkatëse sipas objektit. Kërkesat dhe kërkesëpaditë pas paraqitjes së tyre, regjistrohen brenda ditës së nesërme të punës dhe maksimumi brenda 7 ditëve nga paraqitja në gjykatë i nënshtrohen proçedurës së shortimit elektronik (*Vendim Nr. 238/1/a Datë 24.12.2008 i KLD-së*).
Por pavarsisht se është përmirësuar ndjeshëm në krahasim me vitet e kaluara, vazhdon mbetet një problem i rëndësishëm mungesa e adresave të sakta për palët dhe për njoftimin e tyre si dhe të selive të avokatëve, njoftimi i tyre në adresat elektronike të njohura rregullisht, për të ndihmuar mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, për të mos u bërë pengese në njoftimin e palëve, për mos zvarritjen e gjykimit dhe njoftimin e vendimeve etj. Kjo vjen edhe si pasojë e mungesës së një sistemi të azhornuar të adresave në rrethin e Kurbinit, pasi edhe nga ana e Shërbimit Postar nuk është i mundur gjetja dhe njoftimi i subjekteve në kohë. Po ashtu në këtë problematikë ka ndikuar jo pak edhe fakti që në rrethin e Kurbinit për shkak të pasojave të termetit të vitit 2019 një pjesë e popullsisë janë shpërngulur nga banesat e tyre të dëmtuara duke u vendosur në zona të ndryshme të rrethit dhe jashtë tij.

**MENAXHIMI I SEANCAVE GJYQËSORE**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin janë funksionale gjithsej 4 salla gjykimi në të cilat është i instaluar sistemi ICMIS si dhe Sistemi i Rregjistrimit Audio, ku dy prej tyre kanë dhe ambient për të arrestuar apo të paraburgosur duke mundësuar zhvillimin e seancave për çështje penale.
Kërkesat shqyrtohen nga gjyqtarët e çështjeve të cilët njëkohësisht duhet të menaxhojnë edhe seancat e tjera gjyqësore dhe kërkesat e palëve, duke vepruar gjithmonë brenda mundësive për të respektuar afatet proceduriale për caktimin dhe shqyrtimin e çështjeve gjyqësore. Gjyqtarët trajtojnë me prioritet çështjet që

janë urgjente sipas sanksionimeve ligjore, ndërsa dakordësojnë me palët dhe avokatët rregullisht për kalendarin e gjykimit të çështjes gjyqësore në mënyrë që të mos bëhemn shkak për zvarritje gjykimi. Kalendari i gjykimit është miratuar për ato çështje që zhvillohen me pjesëmarrjen e palëve dhe ato që zhvillohen në dhomë këshillimi. Po ashtu tashmë është instaluar edhe sistemi i realizimit të gjykimeve online apo videokonferencave në sallën nr. 1 të Gjykatës.

## ADMINISTRIMI I GJYKATËS

### 1. KËSHILLI I GJYKATËS

Këshilli i gjykatës përbëhet nga zv. Kryetari i gjykatës ( *në mungesë të kryetarit* ) dhe dy anëtarë të cilët janë gjyqtari më i vjetër në detyrë dhe Kancelari i gjykatës, përbërja e të cilit ndryshoi pas datës 31.12.2021 për shkak të mbushjes së moshës së pensionit nga ana e kancelarit. Ky këshill ka tashmë kompetencat që parashikon ligji Nr.98, datë 06.10.2016. Nga ana e Këshillit të Gjykatës janë zhvilluar mbledhje periodike ku janë trajtuar problemet e hasura gjatë vitit duke mundësuar marrjen e vendimeve përkatëse për zgjidhjen e tyre në shërbim të mirëfunksionimit të gjykatës dhe ofrimit të shërbimeve gjyqësore

### 2. ZV. KRYETARI I GJYKATËS

Në mungesë të kryetarit të gjykatës, kompetencat e plota të tij i ka ushtruar zv. Kryetari i cili ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor. Ai përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët, qofshin këta subjekte të brendshëm apo edhe organizata ndërkombëtare si OSBE, EURALIUS, USAID. Vlen për tu përmendur mbledhja e kryetarëve për unifikimin e praktikave në veprimtarinë e gjyqtarëve. Zëvendëskryetari mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore, disiplinës në punë dhe solemnitetit, duke bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve. Kujdeset nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimit sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në gjykatë.

Theksojmë se vetëm për vitin 2021 janë protokolluar një numër i konsiderueshëm shkresash, të cilat Brenda afateve ligjore janë shqyrtuar nga zëvendëskryetari në bashkëpunim me kancelarin, deleguar dhe më pas punuar nga çdo sektor sipas kompetencave që mbulojnë.

### 3. TRUPA GJYQËSORE

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka në përbërje të saj një trupë gjyqësore prej 4 gjyqtarësh. Në vitin 2021 trupa gjyqësore u plotësua me një gjyqtare dhe konkretisht gjyqtare Alda Sadiku. Për shkak të këtij numri të vogël të gjyqtarëve, gjykata nuk është bërë ndarja në dhoma por nëpermjet nje urdhëri të brendshëm është bërë e mundur periodika e hedhjes së shortit, ku nëpërmjet të cilës është përcaktuar hedhja e tij çdo të hëne në orën 13.00, në prani të të gjithë palëve të interesuara.

### 4. ADMINISTRATA GJYQËSORE DHE PROBLEMET E SAJ

Në lidhje me punën e administratës gjyqësore e shohim të arsyeshme të prekim në këtë analizë shkurtimisht disa probleme, që lidhen në marrëdhëniet me Trupën Gjyqësore.

Administrata gjyqësore përbëhet nga një personel me eksperiencë pune të kualifikuar, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh në mbarëvajtjen dhe ndihmesën e trupës gjyqësore për zgjidhjen drejt dhe në kohë të proçeseve gjyqësore penale e civile, gjatë vitit 2021. Kjo konstatohet nga të dhënat për këtë vit që tregojnë jo vetëm rritje të proceseve gjyqësore por dhe përfundimi i tyre në pak seanca duke i shërbyer një drejtësie pa vonesa.

### 5. ZYRA E KANCELARIT

Zyra e Kancelarit të gjykatës si funksion, ka krijuar mundësitë për të patur një vazhdimësi të mbarëvajtjes së punës me sekretarinë gjyqësore dhe me pjesën tjetër të administratës gjyqësore duke kontribuar në drejtimin

dhe menaxhimin e punës së administratës gjyqësore në shërbim të trupës gjyqësore dhe qytetarëve që kanë nevojë për shërbime gjyqësore.
Kujdes është treguar nga ana e kancelarit për të ndjekur në kohë detyrimet proçeduriale që lidhen me institucionet e tjera, si me Prokurorinë, KLGj-në dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dhe shërbimin ndaj qytetarëvë, duke qëndruar pavarsisht orareve të caktuara të shërbimit, i ka shërbyer në çdo kohë kur ato paraqiten në zyrën e marrëdhënieve me publikun për shërbime të ndryshme, dhe në përmbushjen e gjithë detyrimeve të tjera që ai ka në zbatim të ligjit. Për këtë qëllim në mënyrë që të rritet transparenca ndaj qytetarëve ka funksionuar (*e përditësuar*) edhe një tabelë përpara gjykatës, ku në të është bërë e mundur afishimi i datave dhe orareve të gjykimit javorë, shortimi i çështjeve si dhe afishimi i gjykimeve të Gjykatës së Apelit, apo njoftime të tjera të rëndësishme për publikun si shpallje, vendime, urdhëra etj. Po ashtu në sallën e zyrës së marrdhënieve me publikun funksionon program i planifikimeve që shfaqen në monitor si dhe nga ana e subjekteve të interesuar mund të kontrollohet në një kompjuter lidhur me çështjet për të cilat interesohen.
Gjatë vitit 2021 është punuar me një kujdes të veçantë për mirëmbajtjen e ambjenteve të gjykatës si brënda dhe jashtë saj duke krijuar një ambient të përshtatshëm pune dhe serioz për shkak të natyrës dhe rëndësisë së institucionit.
Nga ana e kancelarit, kryesekretarit dhe administratës është kryer një punë voluminoze për regjistrimin e dosjeve, hedhjen e të dhënave dhe dërgimin e praktikave të tjera administrative pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe KLGj-së, si dhe dërgimin e dosjeve pranë Gjykatës së Apelit në Tiranë Brenda afateve ligjore. Një punë korrekte dhe sistematike është kryer edhe lidhur me statistikat ditore (*sipas kërkesave përkatëse*), javore (*sipas kërkesave përkatëse),* mujore, tremujore dhe vjetore në total apo për nene dhe çështje të caktuara dhe korespodencën përkatëse me KLGj-në, Ministrinë e Drejtësisë si dhe institucione të tjera.
Në përgjithësi është punuar shumë mirë nga të gjithe sekretarët gjyqësorë të cilet iu përgjigjën në kohë të gjithë nevojave dhe problemeve që kanë gjyqtarët në funksion të mbarëvajtjes së proceseve gjyqësore.
Gjatë vitit 2021 është rritur cilësia e punës në mbajtjen e proçesverbalit të seancës gjyqësore, për pasqyrimin saktë dhe me llogjikë të thënieve të palëve dhë të dëshmitarëve, nëpërmjet pasqyrimit të tyre në një monitor të vendosur për këtë qëllim në çdo sallë gjykimi duke punuar në të dy sistemet e instaluara ICMIS dhe AUDIO. Shfaqja e procesverbalit në një monitor të tillë i ka mundësuar palëve që shënimet e sekretarëve gjyqësor të shikohen edhe nga palët dhe dëshmitarët gjatë gjykimit.
Gjithashtu cilësi në rritje janë arritur në zbardhjen e vendimeve dhe dorëzimin në kohë të vendimeve të marra. Vërehet një gatishmëri në përballimin e detyrave të ngarkuara dhe shërbimin në mënyrë më të kualifikuar ndaj qytetarëve duke përcaktuar dhe periodikën e shërbimëve ndaj tyre.
Eshtë detyrë për në vazhdimësi hartimi i Rregullores së re te Gjykatës bazuar edhe në udhëzimet e KLGj-së, si dhe hartimi i regjistrit elektronik dhe dërgimi sipas ligjit tek Departamenti i Administratës Publike për nëpunësit civilë gjyqësorë që e kanë fituar këtë status nëpërmjet vendimeve përkatëse të Këshillit të Gjykatës. Janë regjistruar në sistemin ICMIS për vitin 2021 të gjitha çeshtjet e ardhura për gjykim si penale ashtu edhe civile. Vlen të theksohet po ashtu që duhet të mbyllet në kohë hedhja e vendimeve në sistem për çështjet që ka përfunduar gjykimi. Mirëmbahet në vijimësi faqja ËEB (*portali i gjykatës*), duke pasqyruar çdo ditë njoftimet, publikimet, përditësimet ligjore dhe dokumentacionet e tjera të gjykatës si për njoftimet për seancat gjyqësore, shpallja e njoftimeve për seanca, shpallja e vendimeve etj.
Vetë rritja e volumit të çështjeve dhe ndryshimet ligjore lidhur me afatet ka sjellë si pasojë shtim në ngarkesën e punës për ftuesin gjyqësor. Ftuesi gjyqësor ka patur një ngarkesë të madhe punë, ngarkesë e cila ka ardhur gjithnjë e në rritje për shkak të lëvizjes së popullsisë nga banesat e tyre që u dëmtuan nga termeti i vitit 2019 dhe mungesa e një sistemi të rregullt dhe të azhornuar adresash në rrethin e Kurbinit.

Megjithë këto arritje për të ardhmën na del si detyrë që të përmirësojmë më tej punën dhe të tregojmë një ndjenjë më të lartë përgjegjësie në kryerjen e detyrave, sidomos të bëhet kujdes nga ana e sekretarëve gjyqësorë në thirrjen dhe sistemimin e palëve gjatë proçeseve gjyqësore dhe komunikimi me to, nëpërmjet demonstrimit me etikë dhe kulturë profesionale. Për këtë është bërë e mundur që përveç mikrofonave në sallat 1 dhe 3 funksionon edhe një mikrofon në koridorin e gjykatës që thirrja e palëve me qendër zëri të mos jetë i ndërvaruar nga zhvillimi i gjyqeve apo zënia e sallave me palë ndërgjygjëse.

## 6. KRYESEKRETARI

Kjo zyrë edhe këtë vit ka punuar dhe trajtuar mjaft problematika të reja të dala gjatë punës me qëllim krijimin e praktikave më të mira në zbatim të legjislacionit në fuqi. Lidhur me mënyrën e trajtimit të problematikave që hasim gjatë punës, rruga e ndjekur është përditësimi në rrugë elektronike, por edhe verbale me Kancelarin dhe Zv.Kryetarin e Gjykatës me qëllim trajtimin e tyre.

Nga ana e Kryesekretarisë gjatë vitit janë marrë dosjet në dorëzim pasi janë kontrolluar ata lidhur me mënyrën e inventarizimit të tyre, brenda afateve ligjore, dhe është vijuar me komunikimin e vendimeve përkatëse palëve ndërgjyqëse. Po ashtu nga ana e Kryesekretarisë ju është dhënë forma e prerë vendimeve përkatëse pas përmbushjes së afateve, brenda afateve ligjore si dhe në rastet e vendimeve sipas disponimeve gjyqësore këto vendime janë përcjellë për ekzekutim apo komunikim institucioneve përkatëse.

Ndërsa lidhur me vendimet ndaj të cilëve është ushtruar ankim apo rekurs sipas rastit janë përcjellë në afat në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë sipas rastit. Për vitin 2021 janë ankimuar dhe rekursuar gjithsej 340 vendime, dosjet e të cilëve janë përcjellë për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë. Krahasuar me vitin 2020 rezulton të jenë 100 vendime më shumë në 2021, ç'ka tregon rritje të volumit të punës si për trupën gjyqësore ashtu dhe për administratën gjyqësore.

Një detyrë e rëndësishme, e cila delegohet rast pas rasti, e cila kërkon dhe vëmendje të veçantë, është dhe trajtimi shkresave, kërkesave, ankesave që hyjnë në protokollin e gjykatës. Duke marrë në konsideratë se trajtimi i tyre përbën dhe ngre probleme kryesisht proceduriale, krijimi i Këshillit të Gjykatës, përveç të tjerave në drejtim të funksionimit të sekretarisë gjyqësore, solli risi në drejtim të marrjes së vendimeve sipas referimeve që kemi bërë për probleme të ndryshme proceduriale.

Po ashtu, një problem që kërkon zgjidhje dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve, është dhe njoftimi i vendimeve shtetasve. Nga ana e kryesekretarisë është mundësuar hartimi i Deftesave të Komunikimit të vendimeve gjyqësore menjëher pas dorëzimit të dosjës përkatëse nga gjyqtari, në mënyrë që të vijohet me komunikimin në kohë të tyre subjekteve. Por gjatë vitit 2021 ka vijuar problemi i mungesës së një sistemi adresash i azhornuar për Kurbinin duke vështirësuar jo vetëm punën e Ftuesit Gjyqësor por edhe të Shërbimit Postar ku në mjaft raste ky i fundit i ka vonuar kthimet e deftesave të komunikimit me shënimet përkatëse. Duke u ndodhur përballë këtyre vështirësive për tejkalimin e tyre janë mundësuar takime me drejtuesit e shërbimit postar si dhe nga ana e zyrës së marrdhënieve me publikun si dhe trupa gjyqësore, palëve, ju është kërkuar vënia në dispozicion e numrave të telefonit për komunikim. Kjo është parë si një mundësi e mirë për të shmanguar zvarritjen në njoftimin e seancave gjyqësore dhe në njoftimin e vendimeve konkrete.

## 7. DEGA E BUXHETIT

- **Raporti i Shpenzimeve Programeve per periudhen**

Me fondet e akorduara për funksionimin e aktivitetit të gjykatës tonë, në total shpenzime përsoneli, shpenzime operative dhe investime kemi një plan të rishikuar prej 31,540 mije lekë. Për vitin 2021 realizimi është në vlerën 31,310.7 mijë leke, rreth 99.3% pra kemi realizim të plotë.

- **"Raporti i shpenzimeve të programit sipas Artikujve Buxhetor"**

Siç e thamë edhe më lart fondi i akorduar në total nga buxheti i shtetit për vitin 2021 është 31,540 mijë leke, por sipas artikujve buxhetor kemi një shpërndarje të tillë:

Zeri 600 vlera 22,200 mije lekë plani, realizimi 22200 leke, pra 100 % realizimi i plote plan fakt 19. Ndersa në zërin e sigurimeve shoqërore 601 ku planifikimi është 3,200 mije lekë dhe realizimi 2,988.2 mijë leke kemi një mungesë në realizim të sigurimeve pasi realisht parashikimi mbeshtetet në një mesatare vjetërsie për gjyqtar mbështetur në faktin e një viti më parë por realisht gjykata jonë këtë vit ka patur gjyqtarë të ri dhe pa vjetërsi pune, fakte këto që kanë ndikuar në një realizim me të ulët të sigurimeve shoqerore por vetëm me 1 % më pak se plani. Sa i përket zërit 602 realizimi është në masen 100 % pasi realisht janë kryer prokurimet dhe likujdimet për 11 mujorin 2021.

- **Investimet**

Planifikimi për këtë vit është për blerje paisje elektronike për të cilat për 4-mujorin kemi një plan prej 240 mije lekë që përfshin blerje komjutera për gjyqtaren e re dhe për pritjen e publikut një kompjuter all in one sipas specifikave dhe standarteve të kërkuar.

- Raporti përmbledhes i realizmit të treguesve të përformancës

Sa i përket këtij aneksi kemi paraqitur realizimin e vitit 2021 me numër çështjesh dhe vlera sipas situacionit dhjetor 2021, me një realizim 99.3% të fondeve të akorduara si në të ardhura edhe në buxhet.

Për vitin 2021, planifikimi i produktit A ishte 2100 çështje dhe një realizim prej 2065 çështje. Kostoja për njësi për me 4 mujorin krahasuar me parashikimin është nga 15 sipas parashikimit.

- "Projektet investimet me financim të brendshem" janë planifikaur sipas kodit të projektit blerje paisje elektronike, me plan total 240 mijë lekë me saktësisht me kod produkti M290072 komjutera all in one dhe kompjuter desktop për gjyqtar.

**TABELA 3. SHPENZIMET MUAJI DHJETOR 2021**

| Programi | Kap | Llogaria ekonomike | EMERTIMI | Mujori(progresiv) Plan | Fakt |
|---|---|---|---|---|---|
| **O3310** | **1** | **600** | **PAGA,SHPERB,SHPEN.TJERA** | **22 200 000** | **22 200 000** |
| | | 6001001,1 | *Paga neto* | | 17 364 167 |
| | | 6001001,2 | *Tatim page* | | 2 447 351 |
| | | 6001001,3 | *Sigurim shoqeror 11.2%* | | 1 940 941 |
| | | 6001001,4 | *Sigurim suplementar* | | 436 071 |
| | | 6001013,1 | *Ore jashte orarit gjyqtareve* | | 11 470 |
| | | 6001013,2 | *Ore jashte orarit administrates* | | 0 |
| | | 6001014 | *Kompesime* | | 0 |
| | | 6003300 | *Shperblim* | | 0 |
| **O3310** | **1** | **601** | **KONTRIBUTE TE SIG. SHOQER.** | **3 200 000** | **2 988 245** |
| | | 6010100 | *Kontributi i Sig.Shoq.* | | 2 610 394 |
| | | 6011100 | *Kontributi i Sig.Shendetsore* | | 377 851 |
| **O3310** | **1** | **602** | **MALLRA DHE SHERB.TJERA** | **5 900 000** | **5 882 453** |
| | | **6024** | ***SHPENZIME UDHETIMI*** | **200 000** | **69 500** |
| | | 6024100,1 | *Dieta administrative* | | 0 |
| | | 6024100,2 | *Dieta per komandimet* | | 69 500 |
| | | 6024100,3 | *Dieta per trajnime* | | 0 |
| | | 6024100,4 | *Dieta per kolegjin zgjedhor* | | 0 |
| | | **6020** | ***MATERIALE E SHERBIME ZYRE*** | **0** | **1 222 881** |
| | | 6020100,1 | *Leter* | | 290 520 |
| | | 6020100,2 | *Kancelari* | | 98 790 |
| | | 6020200,1 | *Materiale Pastrim* | | 103 720 |
| | | 6020200,2 | *Gaz ngrohje* | | 0 |
| | | 6020200,3 | *Karburant per Gjenerator* | | 119 991 |
| | | 6020200,4 | *Karburant per kaldaje* | | 0 |
| | | 6020400 | *Tonera* | | 232 080 |
| | | 6020500 | *Shtypshkrime* | | 65 700 |
| | | 6020900 | *Materiale te vogla rutine* | | 98 200 |
| | | 6021007,1 | *Botime* | | 0 |
| | | 6021007,2 | *Abonime* | | 0 |
| | | 6021007,3 | *Njoftime* | | 0 |
| | | 6021001 | *Veshje Uniforma* | | 82 980 |
| | | 6021011 | *Internet* | | 130 900 |
| | | **6022** | ***SHERBIME*** | **0** | **1 570 728** |
| | | 6022001 | *Energji Elektrike* | | 788 939 |
| | | 6022002 | *Uje* | | 23 243 |
| | | 6022003,1 | *Shpenzime faksi dhe telegrafike* | | 0 |
| | | 6022003,2 | *Telefon fiks* | | 62 956 |
| | | 6022003,3 | *Telef.celular* | | 0 |
| | | 6022004 | *Posta dhe Sherbimi Korier* | | 695 590 |
| | | 6022007 | *Komisione bankare* | | 0 |
| | | **6023** | ***SHPENZIME TRANSPORTI*** | **0** | **1 382 912** |
| | | 6023100,1 | *Karburant per automjet* | | 754 023 |
| | | 6023100,2 | *Vaj makine* | | 0 |
| | | 6023200,1 | *Pjese Kembimi.* | | 541 640 |
| | | 6023200,2 | *Goma* | | 0 |
| | | 6023300 | *Siguracioni* | | 38 270 |
| | | 6025600 | *Mirmbajte Mjeteve te Transportit* | | 0 |
| | | 6023900,1 | *Kontroll teknik I makines* | | 28 981 |
| | | 6023900,2 | *Shpenzime larje makine* | | 19 998 |
| | | **6025** | ***SHPENZ.MIRMBAJTJE TE ZAK.*** | **0** | **578 432** |
| | | 6021002 | *Mirembajtje lulishte* | | 69 722 |
| | | 6025400 | *Mirembaj paisje kondicioneri* | | 64 800 |
| | | 6025300 | *Mirmbajte godine* | | 89 800 |
| | | 6025400,1 | *Mirembaj paisje kaldaje* | | 0 |

| Progran | Kap | Art | EMERTIMI | Mujori(progresiv) | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Plan | fakt |
| | | 6025400,2 | *Mirembaj paisje gjeneratori* | | 151 000 |
| | | 6025400,3 | *Mirembajtje telefoni* | | 0 |
| | | 6025400,4 | *Mirembajtje stabilizator* | | 0 |
| | | 6025400,5 | *Mirembajtje central telefoni* | | 0 |
| | | 6025400,6 | *Mirembajtje qender zeri* | | 0 |
| | | 6025400,7 | *Mirembajtje ashensori* | | 0 |
| | | 6025400,8 | *Mirembajtje elektrike* | | 43 000 |
| | | 6025400,9 | *Mirembajtje sistem kunder zjarrit* | | 24 000 |
| | | 6025400,11 | *Mirembajtje sistem sigurie* | | 0 |
| | | 6025800,1 | *Mirembaj paisje fotokopje* | | 118 800 |
| | | 6025800,2 | *Mirembaj paisje kompjuteri* | | 0 |
| | | 6025800,3 | *Mirembaj paisje printeri* | | 0 |
| | | 6025800,4 | *Mirembaj paisje serveri* | | 0 |
| | | 6025800,5 | *Mirembaj paisje fax* | | 0 |
| | | 6025800,6 | *Mirembajtje paisje zyre* | | 17 310 |
| | | 6025800,7 | *Mirembajtje rrjeti kompjuterik(network LAN)* | | 0 |
| | | 6025800,8 | *Miremb.programe(software per menaxh.ceshtjeve gjyqesore.)* | | 0 |
| | | 6025800,9 | *Miremb.programe(software per legjislacionin shqiptar)* | | 0 |
| | | 6025800,11 | *Mirembajtje faqe interneti(faqe web)* | | 0 |
| | | | ***SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE*** | **0** | **1 058 000** |
| | | 6027400 | *Ekzekutime Vendimi* | | **0** |
| | | 6029001 | *Shpenzim pritje percjellje* | | 0 |
| | | 6029002 | *Shpenz. per Aktivitete Sociale* | | 0 |
| | | 6029008 | *Shpenz. Tatim & taksa* | | 35 000 |
| | | 6029004,1 | *Shpenz.siguracion ndertese* | | 0 |
| | | 6029004,2 | *Shpenzim sigurimin e gjyqtareve krimeve* | | 0 |
| | | 6029005,1 | *Shpenz.Pagese eksperti* | | 75 000 |
| | | 6029005,2 | *Shpenz.Pagese psikologe* | | 71 000 |
| | | 6029005,3 | *Shpenz.Avokate* | | 877 000 |
| | | 6029005,4 | *Shpenz.per honorare(bordi)* | | 0 |
| | | 6029005,5 | *Shpenz.perkethime* | | 0 |
| | | 6029005,6 | *Pagese komisjoni per tenderat* | | 0 |
| | | 6029005,7 | *Shpenzime per kolegjin zgjedhor( materiale zyre)* | | 0 |
| | | 6029007,1 | *Shpenz.per konferencen gjyqesore* | | 0 |
| | | 6029007,2 | *Shpenz.per konference nderkombetare* | | 0 |
| | | 6029099,1 | *Shpenzim leje ndertimi* | | 0 |
| | | 6029099,2 | *Shpenzime rruajtjen e objektit* | | 0 |
| | | 6029099,3 | *Shpenzime per pagesa kuotizacioni* | | 0 |
| | | 6029099,4 | *Shpenzime pasaporte sherbimi , diplomatike* | | 0 |
| **O3310** | **1** | **604** | **Transferta korrente te brendeshme** | 0 | 0 |
| | | | | | 0 |
| **O3310** | **1** | **606** | **Trans per Buxh. Fam. & Individ** | **0** | 0 |
| | | 6060099 | *Transferim tek individi (per gjyqtaret ne liste pritje)* | | 0 |
| | | 6061003 | *Ndihme ekonomike* | | 0 |
| **O3310** | | | **INVESTIME** | **240 000** | **240 000** |
| **O3310** | **1** | **230** | ***PROJEKT*** | 0 | 0 |
| | | 2302100,1 | ***Projekt per ndertim te ri te godines.*** | | 0 |
| | | 2302100,2 | ***Projekt per rikonstrusion te plote te godines.*** | | 0 |
| **O3310** | **1** | **231** | ***INVESTIME*** | 240 000 | 240 000 |
| | | 2312101,1 | *Ndertim* | | 0 |
| | | 2312101,2 | *Rikonstruksion i plote* | | 0 |
| | | 2312101,3 | *Rikonstruksion ne nivel mirembajtje* | | 0 |
| | | 2315120 | *Mjete Transporti* | | 0 |
| | | 2318600 | *Paisje elektronike* | 240 000 | 240 000 |
| | | 2314280 | *Paisje sigurie* | | 0 |
| | | 2318100 | *Paisje mobilje* | | 0 |
| | | 2314130 | *Paisje elektrike* | | 0 |
| | | 2318700 | *Paisje te tjera* | | 0 |
| | | | ***T O T A L I*** | **31 540 000** | **31 310 698** |

## TABELA NR. 4 SITUACIONI PËRMBLEDHES

| Grupi | Tit | Kap | Art | EMERTIMI | Mujori(progresiv) | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Plan | Fakt |
| 29 | O3310 | | 600 | PAGA | 22 200 000 | 22 200 000 |
| | | | | | | |
| | | 1 | | *Nga fondet buxhetore* | 22 200 000 | 22 200 000 |
| | | | | | | |
| 29 | O3310 | | 601 | ***KONT. SIG.SHOQERORE*** | 3 200 000 | 2 988 245 |
| | | | | | | |
| | | 1 | | *Nga fondet buxhetore* | 3 200 000 | 2 988 245 |
| | | | | | | |
| 29 | O3310 | | 602 | ***MALLRA e ShERBIME TJERA*** | 5 982 490 | 5 964 943 |
| | | 1 | | *Nga fondet buxhetore* | 5 900 000 | 5 882 453 |
| | | 6 | | *Nga te ardhurat* | 82 490 | 82 490 |
| | | | | | | |
| 29 | O3310 | | 604 | ***TRANS.KORRENTE BRENDSHME*** | 0 | 0 |
| | | | | | | |
| | | 1 | | *Nga fondet buxhetore* | 0 | 0 |
| | | | | | | |
| 25 | O3310 | | 606 | ***TRANS. TEK INDIVIDI*** | 0 | 0 |
| | | | | | | |
| | | 1 | | *Nga fondet buxhetore* | 0 | 0 |
| | | | | | | |
| 29 | O1110 | | 466 | ***MJETE NE RRUAJTJE*** | 2 460 000 | 2 460 000 |
| | | | | | | |
| | | 6 | | *Nga te ardhurat* | 2 460 000 | 2 460 000 |
| | | | | | | |
| 29 | O3310 | | 230 | ***PROJEKT*** | 0 | 0 |
| | | 1 | | *Nga fondet buxhetore* | | |
| | | | | | | |
| 29 | O3310 | | 231 | ***INVESTIME GJITHESEJ*** | 372 301 | 371 000 |
| | | | | | | |
| | | 1 | 231 | Nga fondet buxhetore | 240 000 | 240 000 |
| | | | | *Ndertim* | | |
| | | | | *Rikonstruksion i plote* | | |
| | | | | *Rikonstruksion ne nivel mirembajtje* | | |
| | | | | *Mjete Transporti* | | |
| | | | | *Paisje elektronike* | 240 000 | 240 000 |
| | | | | *Paisje sigurie* | | |
| | | | | *Paisje mobilje* | | |
| | | | | *Paisje elektrike* | | |
| | | | | *Paisje te tjera* | | |
| | | 6 | 231 | ***Investime nga te ardhurat*** | 132 301 | 131 000 |
| | | | | | 132 301 | 131 000 |
| | | | | TOTALI | 31 754 791 | 33 984 188 |

## TABELA NR. 5 REALIZIMI INVESTIMEVE

| Nr | Emertimi i projektit | Objekti i prokurimit | Vlera e plote e projektit | Buxheti 2021 | | | Komente | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Plani | Kontraktuar | Realizuar | Problematika e shkaqet e mosrealizimit | Masat qe propozohen te merren |
| 1 | **Ndertim** | | **0** | **0** | **0** | **0** | | |
| 2 | **Rikonstruksion** | | | | | | | |
| a | *Rikonstruksion i plote* | | | | | | | |
| b | *Rikonstruksion i pjesshëm* | | | | | | | |
| c | *Rikonstruksion ne nivel mirembajtje* | | | | | | | |
| 3 | **Automjet** | | | | | | | |
| 4 | **Paisje mobilje per gjykaten:** | | **240 000** | **240 000** | **240 000** | **240 000** | | |
| *a* | *Paisje elektronike* | blerje kompjutera | 240 000 | 240 000 | 240 000 | 240 000 | | |
| *b* | *Paisje sigurie* | | | | | | | |
| *c* | *Paisje mobilje* | 0 | | | | | | |
| *d* | *Paisje elektrike* | | | | | | | |
| *e* | *Paisje te tjera* | | | | | | | |
| 5 | **Projekt** | | | | | | | |
| a | *Projekt per ndertim te ri godine* | | 0 | 0 | 0 | 0 | | |
| b | *Projekt per rikonstruksion te plote godine* | | 0 | 0 | 0 | 0 | | |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | |
| | **Totali** | | **240 000** | **240 000** | **240 000** | **240 000** | | |

## 8. ZYRA E ARKIVIT

Zyra e Arkivës ka 3 ambjente, një në të cilin mban dosjet nga viti 1993-2012 rregjistrat dhe korespondenca e gjykatës dhe ambienti tjetër mban dosjet e vitit 2013-2020 dhe zyra ku i shërben pritjes së palëve, mbahen kodekset, rafti i provave materiale, kasaforta që mbahen pullat dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat gjyqesore.

**Puna në Arkivë për Vitin 2021**

Dosje dhe vendime të kërkuara nga publiku, palët në proces, avokatët mbrojtës, institucionet dhe të vëna në dispozicion rreth 350 dosje.
Dosje të administruar nga gjyqtarët për bashkim me dosjet në gjykim janë 39 copë, nga të cilat 19 civile dhe 20 penale.
Përveç ofrimit të shërbimeve ndaj të tretëve, janë bërë hyrje në arkivë dosjet që marrin formë të prerë dhe dosje që nuk kanë një rekurs apo janë kthyer nga gjykata e lartë, afersisht 1500 dosje penale dhe civile .
Janë bërë hyrje në arkive 26 prova materiale të ardhura nga Prokuroria Kurbin dhe jenë kryer në total 11 kërkesa për kthim e asgjësime provash.
Janë transferuar në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor dosjet me RHK gjatë vitit 2021, 168 dosje civile të prapambetura të viteve 1993-2008, 356 dosje civile te vitit 2009 dhe 283 dosje civile të vitit 2010.
Janë përpunuar të gjitha dosjet nga 1993-2010 në zbatim të urdhrave të Ministrit të Drejtësisë Nr.4895/4 dhe Nr.4895/5, datë 01.11.2016 “Për miratimin e formateve të listave tip të dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”dhe po vazhdohet me përpunimin e vitit pasardhes.
Është kërkuar nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, trajnim për të përpunuar dosjet penale dhe dokumentacionin administrativ (korespondencen) dhe nga KLGJ punonjë shtesë me kohë të pjesshme për të përfunduar përpunimi i dokumentacionit arkivor.
Ndërkohë mbeten të pa sistemuar dosjet civile dhe penale të vitit 2020-2021 për mungesë hapsire dhe raftesh.
Nga arka janë prerë 510 mandate arkëtime dhe 43 mandate pagese nëpërmjet të cilave janë arkëtuar në **total 1 586 129** lekë nga të cilat **1 483 600** lekë nga pulla e taksës, **53 197** lekë nga njoftimet dhe **49 332** lekë nga fotokopja.

**TABELA NR. 6 TË ARDHURAT PËR VITIN 2021**

| MUAJ | PULLA TAKSE 90% | PULLA TAKSE 10% | NJOFTIME | FOTOKOPJE | TOTALI 2021 |
|---|---|---|---|---|---|
| **JANAR** | 175320 | 19480 | 6040 | 3542 | **204382** |
| **SHKURT** | 72720 | 8080 | 3500 | 1925 | **86225** |
| **MARS** | 103320 | 11480 | 6500 | 7273 | **128573** |
| **PRILL** | 107820 | 11980 | 5780 | 791 | **126371** |
| **MAJ** | 144720 | 16080 | 4270 | 7700 | **172770** |
| **QERSHOR** | 179280 | 19920 | 4240 | 5642 | **209082** |
| **KORRIK** | 104040 | 11560 | 3140 | 1414 | **120154** |
| **GUSHT-SHTATOR** | 175140 | 19460 | 6447 | 9040 | **210087** |
| **TETOR** | 88380 | 9820 | 5000 | 11109 | **114309** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **NENTOR** | 112500 | 12500 | 5540 | 896 | **131436** |
| **DHJETOR** | 72000 | 8000 | 2740 | 0 | **82740** |
| **TOTALI** | **1335240** | **148360** | **53197** | **49332** | **158612 9** |
| | | | | | |




## 9. Zyra e IT / Marrëdhënien me publikun

Gjykata e Kurbinit aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ICMIS. Ky sistem gjatë viteve është përmirësuar dhe konfiguruar, duke iu përshtatur nevojave të gjykatës për implementimin e ndryshimeve ligjore. Pajisjet kompjuterike me të cilat punojnë gjyqtarët dhe stafi janë prodhim i vitit 2011 deri ne vitin 2021.Në gjykatë punohet kryesisht më programin Ëord 2007-2010, me kompjutera kryesor FUJISTSU,ACER, HP. Nuk ka një bazë të integruar të të dhënave ku gjyqtarët të kenë një akses të lehtësuar në jurisprudencë, ligjet e ndryshuara, pasi mungon një kodifikim i këtyre ligjeve me përmbajtje të integruar i një cilësie të lartë, që ndihmon gjyqtarët në punën e përditshme.

Teknologjia e Informacionit po përmirësohet gjithmonë dhe më tepër bazuar në rekomandimet dhe specifikimet e Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Parametrat teknikë të paisjeve janë përmirësuar. Mirëmbahet sistemi ICMIS dhe Audio plotësisht. Realizohet çdo ditë në një kompjutër të veçantë të specialistit të IT backup-i manual dhe automatik për gjithë të dhënat periodike. Ka një rregullore të brendshme të IT e cila zbatohet në përgjithësi mirë nga të gjithë përdoruesit. Sidoqofte vlen të theksohet që

sistemi i passëordeve duhet të ndrohet më shpesh nga përdoruesit për efekte sigurie kibernetike. Parametrat e internetit janë shumë të larta 100 MBps doënload/100 Mbps upload që garanton shpejtësinë e punës në sistem. Janë regjistruar në sistemin ICMIS për vitin 2021 të gjitha çeshtjet e ardhura për gjykim si penale ashtu edhe civile. Vlen të theksohet për sekretarët gjyqësorë që duhet të mbyllin në kohë vendimet që ka përfunduar gjykimi. Është realizuar anonimizimi i të dhënave personale në portal në mënyrë automatike. Mirëmbahet në vijimësi faqja ËEB (*portali i gjykatës*), duke pasqyruar çdo ditë njoftimet, publikimet, përditësimet ligjore dhe dokumentacionet e tjera të gjykatës si për njoftimet për seancat gjyqësore, shpallja e vendimeve etj

**TABELA NR. 7 LLOJI I PAISJEVE SIPAS PERDORUESVE**

**1. Gjyqtarët**

| Nr | Emertimi i pajisjeve elektronike | Paisjet | | Informacione teknike rreth Kompjuterit/Kompjuterave | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Sasi i total | Sasia/viti blerjes | Lloji | Sistemi Windows (Versioni) | Madhësia HDD | RAM |
| 1 | Kompjuter | 4 | 1 / 2016 | **Fujitsu** | Windows 10 | 500 GB | 4 GB |
| | | | 1 / 2013 | Fujitsu | Windows 7 | 500 GB | 4GB |
| | | | 2 / 2020 | ACER | Windows 10 | 500 GB | 8 GB |
| 2 | Printer Laserjet | 4 | 3/2018, 1/2015 | | | | |
| 3 | UPS | 4 | 1/2016, 1/2015, 2/2020 | | | | |

**2. Zyrat e Sekretareve Gjyqësore**

| Nr | Emertimi i pajisjeve elektronike | Paisjet | | Informacione teknike rreth Kompjuterit/Kompjuterave | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Sasi i total | Sasia/viti blerjes | Lloji | Sistemi Windows (Versioni) | Madhësia HDD | RAM |
| | Kompjuter | 5 | 1/2020 | Acer | Windows 10 | 1 TB | 16 GB |
| | | | 1/2019 | FUJITSU | Windows 10 | 1TB | 8 GB |
| | | | 2/2018 | ACER | 1/WINDOWS10,1/WINDOWS 7 | 1TB,500MB | 8GB |
| | | | 1/ 2015; | FUJITSU | Windows 7 | 500MB | 4GB |
| 2 | Printer Laserjet | 5 | 3/2015 ;2/2018 | | | | |
| 3 | UPS | 5 | 2/2018 ; 1/2017 ; 2/2020 | | | | |

**3 Zyra e IT**

